



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**Anr. 488/2019**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Rustem Thaqi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjor Lutfie Morina Ajvazi, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik koalicionit NISMA-AKR-PD, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të parregullsive në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me 18.11.2019, mori këtë:

## **V E N D I M**

**REFUZOHET** e pabazuar ankesa Anr. 488/2019 me datë 16.11.2019, e paraqitur nga Koalicioni NISMA-AKR-PD, me seli në Prishtinë, e paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) - Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), me të cilën ka kërkuar që të shpallet i vlefshëm një fletëvotim në Vendvotimin 0702D/02D.

## **A r s y e t i m**

PZAP-i, me datë 16.11.2019, ka pranuar një ankesë Anr.488/2019 nga subjekti politik koalicioni NISMA-AKR-PD, në të cilën pretendon se me datë 16.11.2019, në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), gjatë numërimit të votave në kutin e votimit 0702D/02D, është shpallur një fletëvotim i vlefshëm në kundërshtim me Doracakun e Procedurave të Votimit dhe Numërimit të KQZ-së. Sipas parashtresës të ankesës KQZ-ja, e ka shpallur të vlefshme këtë fletëvotim me arsyetimin se votuesi në rastin e shënimit të shenjës “W” e cila e prekë edhe hapësirën e subjektit politik KDTP, me nr. 127, dhe se ky shkrim me shenjën “W” përbën paqartësi të qëllimit të votuesit se për cilin subjekt ka pas për qëllim të votoj.

Parashtresë i ankesës thekson se bazuar në Doracakun e Procedurave të Votimit dhe Numërimit të KQZ-së, sipas shtojcës nr.8 (Mostër e fletëvotimit të Pavlefshëm ), ky fletëvotim duhet të shpallet i pavlefshëm për arsye se në fletëvotim si provë nga vendvotimi 0702D/02D, vërehet se votimi është bërë në hapësirën e këtij subjekti politik, mirëpo shkrimi (votimi) me një shenjë “W” prekë edhe hapësirën e subjektit politik, me nr. 127 të KDTP-se, më tutje thekson se ky shkrim (votim) me shenjë “W” përbën paqartësi të qëllimit të votuesit se për cilin subjekt ka pas qëllim të votoj.

Në përgjigjen e KQZ-së, të pranuar përmes email-it, më datë 17.11.2019, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ( KQZ) pas shqyrtimit të ankesës dhe pretendimeve të palës ankuese thekson se Ligji për Zgjedhjet thotë se fletëvotimi shpallet i vlefshëm në rast se dihet qëllimi i qartë i votuesit, më tutje thekson se “në rast kur votuesi ka shënuar për subjektin por ka kaluar fushën e subjekteve tjera, dhe ato raste kur ka prekur shkrimin e subjektit tjetër është shpallur i pavlefshëm bazuar në doracak ndërsa kur nuk ka prekur shkrimin e subjektit tjetër është shpallur i vlefshëm”.

PZAP-i, pas shqyrtimit të ankesës, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe vlerësimit të provave të bashkangjitura, në ankesë në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

#### **Ankesa është e pabazuar**

Nga shkresat e lëndës konstatohet se në kutitë e votimeve: 0702D/02D është shpallur nga ana e QNR-së një fletëvotim i vlefshëm, për shkak se shenja ”E”, e vendosur tek njëri subjekt ka kaluar apo i ka përshkruar dy subjekte. Si rezultat i këtyre konstatimeve QNR-ja, me rastin e numërimit e ka shpallur të vlefshme këtë fletëvotim.

Subjekti politik koalicioni NISMA-AKR-PD, si palë ankuese ka paraqitur ankesë në kuptim të nenit 105 paragrafi 1 të LZP-së dhe nenit 8 par. 1 të Rregullores Zgjedhore NR. 06/2013, brenda afatit ligjor kur ka kërkuar nga PZAP-i, që këtë fletëvotim ta shpallë të pavlefshme sepse përbën paqartësi të qëllimit të votuesit se për cilin subjekt ka pas për qëllim të votoj.

Paneli, me rastin e pranimit të ankesës, përgjigjes në ankesë, ka formuar ekipin hetues dhe ka dërguar në QNR, për të zhvilluar hetime në raport me pretendimet e cekura nga ankuesi. Pas përfundimit të hetimit në QNR, Paneli ka gjetur se nuk qëndron pretendimi i ankuesit se pa të drejtë një fletëvotim i gjetur në kutitë e votimit 0702D/02D është shpallur i vlefshëm, pasi që nga ekzaminimi i të njëjtit ka rezultuar se nuk e përmbush asnjërin kriter të pa vlefshmërisë, e njëjta duhet të llogaritet e vlefshme dhe rezultati i të njëjtës duhet t'i bashkëngjiten rezultatit përfundimtar të publikuar me datë 07.11.2019.

PZAP-i, më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura vendimin e ka bazuar në nenin 119 paragrafi 5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze*”, lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Andaj, Paneli në kuptim të nenit 117 dhe nenit 118 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**Anr. 488/2019 më datën 18.11.2019**



**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.